



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipal Kaçanik-

-Kuvendi i Komunës-

I	Data	31.01.2014	endi	Kaçanik
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01		16-3234	9/13

Në bazë të nenit 40.2(d) të Ligjit Nr. 03L-/040- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 e datës 04 qershor 2008), të neneve 34.5 dhe 36 lidhur me nenet 40, 41 dhe 42 të Statutit të Komunës, të nenit 15(c) lidhur me nenin 24 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, nenit 4 të Rregullores për Transparencë Komunale, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31.01.2014, merr këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS
KAÇANIK PËR VITIN 2014

I.

Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës Kaçanik, për vitin 2014.

II.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në vitin 2014, Planifikon t'i mbajë gjithsej, 10 Mbledhje të Rregullta.

III.

Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës, do të mbahen sipas këtij Plani të Punës:

PLANI I MBLEDHJEVE TË KUVENDIT

	Numri i mbledhjeve	Periudha Kohore	Vendi i mbajtjes	Ora	Rendi i Punës	Kryesimi i mbledhjeve
1	2	3	4	5	6	7
01.	Mbledhja e I-r	24-31.01.2014	Katin e III-të, në Sallën e Kuvendit	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës;</p> <p>2. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;</p> <p>3. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;</p> <p>4. Plani i Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2014;</p> <p>5. Propozim Vendimi për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga viti 2012 dhe 2013, në vitin 2014 (DEFZH);</p> <p>6. Propozim Vendimi për zgjerimin-ndërtimin e fushës sportive të stadiumit të qytetit, Besnik Begunca, (DUKMM);</p> <p>7. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, (DAK);</p> <p>8. Propozim Vendimi për ndarjen e bursave të studentëve të Komunës së Kaçanikut për vitin akademik 2013/2014, (Kryetari);</p> <p>9. Propozim Vendimi për financimin e</p>	Kryesuesi i KK

					shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura nga qytetarët e komunës së Kaçanikut (Kryetari).	
02.	Mbledhja e II-të	24-28.02.2014	- " -	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I-ë e Rregullt e kuvendit të komunës, për vitin 2014;</p> <p>2.Plani i Punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2014, (Kryetari);</p> <p>3.Propozim Vendimi për Formimin e Komisionit për ndarjen e bursave për studentë të caktuar të komunës;</p> <p>4. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013, (DEFZH);</p> <p>5. Propozim Vendimi për ndryshimin e destinimit të parcelave kadastrale 664 ZK Kaçanik, pronar Avdyl Fahri Gula, sipas PZHU, nga P+2 në B+P+5. (DUKMM);</p> <p>6. Propozim Vendimi për miratimin e taksave administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës, (DUKMM);</p> <p>7. Propozim Vendimi për definimin e statusit të NKP, Lypeteni (DSHPE).</p>	-"-

03.	Mbledhja e III-të	24-31.03.2014	--	11:00	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e II-të e Rregullt e kuvendit të komunës; 2. Raporti i Punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2013(Kryetari); 3. Propozim Vendimi për Lejimin e mjeteve financiare për realizimin e Projekteve të (DBPZHR); 4. Propozim Vendimi i Rregullores komunale për lirim nga taksat e lejeve të ndërtimit për personat të cilët subvencionohen me grante qeveritare për zhvillimin e bujqësisë, (DUKMM). 	--
04.	Mbledhja e IV-të	24-30.04.2014	--	11:00	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e III-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2. Propozim Rregullorja për procedurat e dhënies së objekteve të komunës dhe tokës në shfrytëzim afatshkurtër përmes procedurës së tenderimit, (DUKMM); 3. Raporti për realizimin e mjeteve buxhetore për periudhën: janar-mars, 2014, (DEFZH); 4. Raporti i Komisionit për ndarjen e bursave të studentëve të komunës. 	--
05.	Mbledhja e V-të	26-30.05.2014	--	11:00	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IV-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2. Propozim Vendimi për eksproprijimin e tokave për ndërtimin e shtratit të lumit Lepenc dhe të lumit 	--

					Neredime, (DUKMM) .	
06.	Mbledhja e VI-të	26-30.06.2014	-“-	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e V-të e Rregullt e kuvendit të komunës;</p> <p>2. Propozim Vendimi dhe Pasqyrat Financiare për Rishikimin Gjashtëmujorë të Buxhetit të komunës për vitin 2014, (DEFZH);</p> <p>3. Raporti i Auditivit të Jashtëm (ZAGJ), për vitin 2013,</p> <p>4. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e Rregullores për lirim nga taksat e ndërtimit për objektet e organizatave fetare dhe institucionet publike, (DUKMM).</p>	-“-
07.	Mbledhja e VII-të	28-31.07.2013	-“-	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VI-të e rregullt e kuvendit të komunës;</p> <p>2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve të komunës së Kaçanikut, për periudhën e viteve 2015-2017, (DEFZH);</p> <p>3. Raporti për realizimin e mjeteve buxhetore, për periudhën, Janar-Qershor, 2014, (DEFZH).</p>	-“-
08.	Mbledhja e VIII-të	24-30.09.2014	-“-	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VII-të e rregullt e kuvendit të komunës;</p> <p>2. Propozim Vendimi për Rregullimet buxhetore nga ndarjet me buxhetin e komunës, për vitin 2014 (nëse ka), (DEFZH);</p>	-“-

					<p>3. Draft - Buxheti i Komunës për vitin 2015 dhe vlerësimet për periudhën e viteve, 2016-2017, (DEFZH);</p> <p>4. Propozim-Rregullorja për vendosjen e Tatimit në Pronë, në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2015, (DEFZH);</p> <p>5. Draft Rregullorja për marrjen e masave dhe veprimeve për mbrojtjen nga zjarri, (DSHPE);</p> <p>6. Plani i evakuimit të personelit në raste emergjente, (DSHPE);</p> <p>7. Propozim Vendimi për Rishikimin e PZHU dhe PZHK, (DUKMM).</p> <p>8. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e vitit shkollor 2013/2014, (DAK).</p>	
09.	Mbledhja e IX-të	27-31.10.2014	-“-	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VIII-të e rregullt e kuvendit të komunës;</p> <p>2. Raporti për realizimin e mjeteve buxhetore, për periudhën, Janar-Shtator 2014, (DEFZH);</p>	-“-
10.	Mbledhja e X-të	24-28.11.2014	-“-	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IX-të e rregullt e kuvendit të komunës;</p> <p>2. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2015, Kryetari).</p> <p>3. Plani i Punës së kuvendit të komunës për vitin 2015.</p>	-“-

IV.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në muajin shtator do të mbajë dëgjim publik me qytetarë për çështjen e Draft-buxhetit të komunës për vitin 2015 dhe projeksionet për vitet: 2016-2017, para se të aprovohet drafti i buxhetit në kuvend.

V.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, gjat vitit 2014, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të Rregullta më me shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e Rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.

VI.

Materialet që i adresohen Kuvendit të Komunës, janë kryesisht çështje të propozuara nga ekzekutivi i komunës, e që kalojnë procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit të KPF-a, dhe të njëjtat, me Rekomandim të KPF-a i kalojnë KK për shqyrtim dhe miratim apo në procedurë të mëtejme.

VII.

Të gjitha mbledhjet e Rregullta të KK do të jenë hapura për qytetarë dhe përfaqësuesë të mediave publike. Nese ndonjë mbledhje e Rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura, atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nese mbledhja mbahet me dyer të hapura, në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarë të komunës dhe përfaqësuesë të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

VIII.

Njoftimet për mbledhje të Kuvendit të Komunës bëhen publike. Materialet për Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës iu dërgohen anëtarëve të Kuvendit të Komunës 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe Materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

IX.

Kuvendi i Komunës për gjatë muajit gusht do të jetë në Pushim Vjetorë. Për fillimin dhe mbarimin e pushimit, anëtarët e kuvendit do të njoftohen paraprakisht. Për gjatë pushimit nuk planifikohet mbajtja e ndonjë mbledhje përveç nëse paraqitet ndonjë çështje eventuale, atëherë nuk përjashtohet mundësia të mblidhet Kuvendi i Komunës.

X.

Plani i Mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në pikën III. të këtij Vendimi, është orientues e nuk do të thot se nuk pëson ndryshime, sipas Kërkesave të Ekzekutivit të komunës dhe nevojave që paraqitën.

XI.

Plani i Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2014, ka fuqi veprimi nga data: 01.01.2014-31.12.2014.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi